



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI**

Adresa: Bulevardi Bajram Curri", Tiranë, Albania, Tel / Fax: +355 4 362937

Nr. 1674 Prot.

Tiranë, më 24 / 4 2012

URDHËR

Nr. 173 datë 24.04.2012

PËR

**“VAKSINIMIN NDAJ TETANOZIT TË GRAVE SHTATZËNA NË RASTET
SPECIFIKE TË KONSIDERUARA ME RREZIKSHMËRI TË LARTË”**

Bazuar në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 12 të Ligjit Nr.9000, datë 30.01.2003 për “Organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të Ligjit Nr.10138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik” dhe të Ligjit Nr.7761, datë 19.10.1993 “Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse”

URDHËROJ

1. Të sigurohet vaksinimi i grave shtatzëna vetëm në rastet specifike të konsideruara me rrezikshmëri të shtuar, sipas shtojcës bashkëngjitur këtij urdhëri.
2. Në Udhëzimin Nr. 146, datë 11.04.2003 “Në mbështetje të ligjit nr. 8876, datë 04.04.2002, “Për Shëndetin Riprodhues” dhe në veçanti të neneve 14, 21, 24, 25 të këtij ligji, Pika 5, germa c, rreshti 11 që ishte: “bëhet imunizimi antitetanik dhe pas një


muaji doza e dytë” ndryshohet si vijon: “bëhet imunizimi antitetanik vetëm në rastet specifike të konsideruara me rrezik të lartë sipas shtojçës bashkëngjitur këtij urdhëri”.

3. Të ruhen nivelet optimale të asepsisë përgjatë procesit të lindjes, për çdo rast lindje të asistuar nga personel i kualifikuar shëndetësor dhe në institucionet shëndetësore.
4. Ngarkohen ASHR, DRSH, DSHP dhe ISHP për zbatimin e këtij Urdhëri.
5. Ngarkohen DSHP në MSH dhe ISHP për monitorimin e zbatimit të këtij Urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

PETRIT VASILI



Shtojca: Udhëzim mbi vaksinimin e grave shtatzëna për Tetanozin

- *Vaksinim i panjohur dhe jo i plotë për Tetanozin:* Për të siguruar mbrojtjen ndaj tetanozit të nënës dhe atij neonatal, gratë shtatzëna **që nuk janë vaksinuar asnjëherë ndaj Tetanozit** duhet të marrin tre doza të vaksinës që përmban tetanoz apo tetanoz dhe difteri (me doza të reduktuara të toksinës) si TT dhe Td.

Skema e rekomanduar e vaksinimit mund të fillojë në fund të tremujorit të dytë dhe në tremujorin e tretë të barrës (pra pas 20 javëve të shtatzanisë) dhe është si më poshtë: 0 (I), 4 (II) javë, 6 - 12 (III) muaj.

- *Vaksinimi rutinë:* Në rast se një grua shtatzënë nuk është vaksinuar në fëmijërinë e saj për difteri, tetanoz dhe pertus, atëherë kjo grua duhet të vaksinohet, për të tria këto sëmundje me vaksinën Tdap (ku kemi reduktim të toxoidit të difterisë apo të pertusit aceluar) në tremujorin e tretë apo në fund të tremujorit të dytë, (dmth pas 20 javëve të shtatzanisë). Vakcina Tdap nuk ofrohet në shërbimet shëndetësore publike. Kjo vaksinë ofrohet nga Sanofi Pasteur dhe GlaxoSmithKline Biologicals.
- **Në rast se një grua shtatzënë ka përfunduar të gjithë skemën e vaksinimit në fëmijërinë e saj me vaksinën DTP/DT/Td nuk është e nevojshme të vaksinohet gjatë shtatzanisë me vaksinën tetanike përveçse në situata të veçanta si më poshtë.**
- *Për situata të veçanta:*
 - a) Gra shtatzëna që mund të lindin në shtëpi kryesisht në zona të thella dhe kur mjeku obstetër-gjinekolog parashikon lindje në kushte jo spitalore, rekomandohet vaksinimi me vaksinën e Tetanozit apo me vaksinën Td.
 - b) Menaxhimi i plagëve: Në rast se gruaja pëson aksident apo ka plagë dhe ku rekomandohet vaksinimi i tetanozit, ajo mund të vaksinohet menjëherë me Td apo vetëm me vaksinën e tetanozit.

Të gjithë mjekët obstetër-gjinekologë apo mjekët e familjes dhe të konsultorit të gruas dhe fëmijes duhet:

- të zbatojnë udhëzimin e mësipërm.
- të pyesin gruan shtatzënë në lidhje me historinë e vaksinimit apo situatat e veçanta dhe ta informojnë në lidhje me rreziqet e Tetanozit dhe sidomos atij neonatal në rast se gruaja nuk ka qenë asnjëherë e vaksinuar ndaj Tetanozit.
- të dokumentojnë çdo vaksinim të gruas shtatzënë në regjistrin e vaksinimit duke shënuar edhe vaksinën përkatëse (sipas atyre të përshkruara me lart). Po kështu, në regjistër shënohet edhe nëse gruaja ka qenë e vaksinuar më parë apo nëse ka faktorë risku.

Epidemiologu i rrethit duhet:

- të kontaktojë me mjekët përkatës për të shpjeguar udhëzimin e mësipërm.
 - të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi dhe dokumentacionin që duhet mbajtur në lidhje me të.
 - të raportojë çdo tre muaj pranë ISHP si më poshtë:
1. Sa gra shtatzëna janë vaksinuar përkatësisht me TT, Td, Tdap dhe grup moshat përkatëse
 2. Dokumenton për çdo vaksinim, historitë e vaksinimit dhe faktorët e riskut.

Pergatitur nga,

Instituti i Shëndetit Publik

Silvia Buro

A stylized handwritten signature in black ink, consisting of a large, looped initial 'S' followed by a horizontal line extending to the right.